



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-11-0186

Paditësi

Sh P, nga Prishtina
të cilin e përfaqëson av R S, Prishtinë.

Kundër

E Paditura

N.SH “Fazita”, Fabrika e Tapetave të Murit, Prishtinë,
përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**
rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 25 tetor 2022, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Kërkesëpadia e paditësit Sh P e paraqitur me datë 23 korrik 2011, hedhet poshtë si të papranueshme.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 23 korrik 2011, paditësi përmes përfaqësuesit të tij parashtrij padi kundër të paditurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtorë i Ndërmarrjes Shoqërore N.SH-së “Fazita”, Fabrika e Tapetave të Murit (tash e tutje “NSH”), me tepër se 10 vite e cila pastaj u privatizuar nga e Paditura. Ai përmes padis dhe përgjigjes së datës 03 mars 2014 kërkon nga gjykata që ti njihet e drejta në 20 % të hyrave nga shitja e NSH-së duke u bazuar në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Si dëshmi paditësi ka bashkangjitur një kopje të Aktvendimit mbi caktimin e punëtorit në punët dhe detyrat e punës dt. 23 maj 1997.

Me 24 nëntor 2011, gjykata ka kërkuara nga paditësi që të përkthej në gjuhën angleze padinë dhe aktvendimin e bashkangjitur.

Me 04 janar 2012, paditësi me parashtrësë ka kërkuara nga gjykata që ta liroj atë nga shpenzimet e përkthimit.

Me 08 nëntor 2012, Gjykata me urdhër ka kërkuara nga paditësi dhe përfaqësuesi i tij që të dorëzojnë në gjykatë autorizimin e avokatit për përfaqësim.

Përmes parashtrësës së dt. 04 dhjetor 2012, përfaqësuesi i paditësit ka dorëzuar autorizimin me shkrim për përfaqësimin e paditësit në gjykatë.

Me 10 dhjetor 2012, Gjykata me Aktvendimin SCC-11-0186, ka aprovuar kërkesën e paditësit për ndihëm rreth përkthimit.

Me 18 dhjetor 2013, e paditura AKP-ja përmes mbrojtjes ka pohuar se ankesa duhet të hidhet poshtë si e pa pranueshme pasi që paditësi ka parashtruar kërkesë jashtë afatit kohorë të parapara për çështjen e 20 % e cila ka përfunduar para shumë viteve. Ka shtuar se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka vendosur për çështjen e 20% me Aktgjykimin nr. SCEL-05-0001 me dt.07 prill 2006.

Me urdhrin e dt. 29 janar 2014, Gjykata ka dorëzuar mbrojtjen e të paditurës tek përfaqësuesi i paditësit, në mënyrë që ai të ushtroj përgjigje ndaj mbrojtjes.

Me 03 mars 2014, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur përgjigje ndaj mbrojtjes, duke shtuar se ai kërkon që paditësit ti njihet e drejta në 20 % të hyrave nga shitja e NSH-së duke u bazuar në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesëpadia e paditësit është e papranueshme.

Nga aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. SCEL-05-0001 i datës 07 prill 2006, gjykata vëren se N.SH“ Fazita ” u privatizua me 23 shkurt 2005. Me 30, 31 mars dhe 02 prill 2005 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) publikoi listën zyrtare të të punësuarve të cilët janë konsideruara me të drejtë legjitime për të marr pjesë në të ardhurat nga privatizimi i N.SH- “Fazita”, në Prishtinë. Afati për dorëzimin e ankesave në gjykatë ka qenë 25 prill 2005.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, (tani e tutje DHP) me Aktgjykimin SCEL-05-0001 të datës 07 prill 2006, kishte vendosur në lidhje e ankesat e paraqitura kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, lidhur me ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore NSH-së “Fazita”, Prishtinë.

Neni 10.6 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 thotë, (lidhur me nenin 67.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6 :

“Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime...”

Paditësi ka bërë kërkesë/ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, me 23 korrik 2011, ndërsa afati i fundit për paraqitjen e ankesave ka qenë 25 prill 2005, që i bie se paditësi ka paraqitur kërkesë në gjykatë 5 vite me vonesë.

Gjykata bën një vështrim të përgjithshëm dhe thekson se afatet kohore procedurale janë nënkategori e kategorisë së përgjithshme “afatet”. Afati procedural është periudhë kohore e specifikuar të cilës i detyrohet padia/ankesa, parashtrësia apo veprimi. Prandaj, të gjitha veprimet procedurale duhet të zbatohen brenda afateve të përcaktuara me ligj dhe e drejta për të ushtruar veprim procedural përfundon me skadimin e atij afati.

Parimet e përmendura më lartë mund të gjenden në secilin sistem apo juridiksion ligjor. Rregulli përcaktohet në mënyrë të qartë për të lënë sigurinë e nevojshme të afateve kohore në procedurë, duke pasur parasysh veçanërisht zhvillimin e drejtë të procedurës pran gjykatës. Në fakt, lejimi i palës për të parashtruar padi, ankesë apo ndonjë parashtrësë tjetër në çfarëdo kohë, përkundër dispozitës së qartë të afatit kohor të paracaktuar do të shkelte parimin e ‘sigurisë së ligjit’ dhe do të ishte shkelje e rregullave të përcaktuara me ligj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pran gjykatës.

Këto parime janë gjithashtu në përputhje me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut. Në të vërtetë, pasi që Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut ka theksuar se e drejta për qasje në drejtësi nuk është e drejtë absolute por i nënshtrohet kufizimeve, përkatësisht krijimi i afateve kohore të detyrueshme dhe që nuk mund të zgjaten për ndërmarrjen e masave procedurale (*Edificationes March Gallego S.A. v. Spain, 28028/95*).

Megjithatë jeta reale mund të ofrojë zgjidhje për të cilat rregullat e përgjithshme të shpjen në rezultate të pafavorshme që ndikojnë në ndjenjën shoqërore të drejtësisë. Për të rregulluar situatat e tilla, sistemet ligjore krijojnë ‘valvula të sigurisë’, korniza ligjore që lejojnë në rrethana specifike.

Në rastet e afateve kohore procedurale, ligji ofron ‘valvula të sigurisë’: siç është kthimi në ‘status quo ante’ (gjendjen e mëparshme) (nenet 129-133 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm ex vi edhe me Ligjin për DHPGJS-në).

Gjyqtari mund ta lejojë palën, me kërkesën e tij, që të ndërmerr veprim me vonesë për të parashtruar ankesë kundër listës zyrtare të punëtorëve, në rast se gjen se ka ekzistuar bazë e arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikoheshin apo shmangeshin. Megjithatë, kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme duhet të parashtrohet 60 ditë pas datës së dështimit për të vepruar, dhe në mënyrë kumulative, brenda 7 ditëve nga përfundimi i bazës për të vepruar brenda afatit kohor të caktuar. Në të njëjtën kohë parashtruesi i kërkesës duhet të detyrohet që të bashkëngjisë me shkrim kërkesën të cilën ai ka dështuar ta parashtrrojë brenda afatit kohor.

Nga se u tha me lartë, pasi që kërkesa e paditësit është paraqitur pas afatit ajo hedhet poshtë në baza të papranueshmërisë.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta. Paditësi e ka paguara taksën gjyqësore, andaj nuk ngarkohet me taksë shtesë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar